



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I. Numër: 01-112-01-70653, dt.30. Shtator 2020.

Në bazë të nenit 12. Paragrafi 2. pika d) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 dt.04. Qershor 2008"), nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-092, për dhënjën në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10 dt. 03 prill 2019"), nenit 18. të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, dt. 10. Gusht 2020, nenit 8, nenit 9 paragrafi 1 shkronja d) dhe nenit 14 paragrafi 1 shkronja c) të Statutit të Komunës së Pejës, 01 Numër: 09-8103. dt.29. shtator 2008, në Kërkesë për rishqyrtim Nr. 020-798/7 dt. 19.08. 2020 të MPL-së, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me date: 30. Shtator 2020, muarr këtë:

V E N D I M

Nr. 47/2020.

Mbi formimin e Komisionit të ankesave, për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënjes në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës

1. MIRATOHET Vendimi për formimin e Komisionit të Ankesave, për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënjes së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë.

2. Komisioni i Ankesave formohet në përbërje 5 (pesë) anëtarëve, si vijon:

- | | |
|--|---------------------|
| 2.1. Naser Gega, anëtarë e Kuvendit, nga subjekti politik LDK, | anëtarë, |
| 2.2. Beqir Kajtazi, anëtarë i Kuvendit, nga subjekti politik AAK, | anëtarë, |
| 2.3. Xhevahire Çeku Kelmendi, nga Ekzekutivi Komunal, | anëtarë, |
| 2.4. Mehdi Mulaj, nga Ekzekutivi Komunal, | anëtarë, dhe |
| 2.5. Vesel Nikqi, përfaqësues nga Shoqëria civile, | anëtarë. |

3. Mandati i komisionit të ankesave është 2 (dy) vjeçar brenda mandatit të Kuvendit të Komunës.

4. Kryesuesi i komisionit të ankesave zgjidhet me shumicë të votave të anëtarëve të komisionit dhe ai kryeson punën e komisionit.

5. Detyrë e komisionit të ankesave është:

- 5.1. Pranimi i ankesave të paraqitura në vlerësimin e ofertave,
- 5.2. Shqyrtimi i ankesave,
- 5.3. Njoftimi me vendimin e marrë të Kryesuesit dhe Kryetarit të Komunës.

6. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit të ankesav sipas kërkesës së tyre.

7. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës.

8. Me miratimin e këtij vendim bëhet shfuqizimi i Vendimit Nr.41/2018 dt. 29. Qershor 2018, i Kuvendit Komunal Pejë, me numër protokollit:01.Numër: 01-112/01 – 66943 si dhe Vendimi Nr. 41/2020 dt. 30.06.2020.

9. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MPL-së si dhe 7 (shtat) ditë pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Pejës.

Dorezohet:

- 1x1. MPL.
- 1x1. Kryetarit të Komunës
- 1x1. Anëtarëve të Komisionit.
- 1x1. Arkivë.



KRYESUESI I KUVENDIT
Dr. Islam Husaj